



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

NJËSIA PËR INTELIGJENCË FINANCIARE
FINANSIJSKA OBAVESTŠAJNA JEDINICA
FINANCIAL INTELLIGENCE UNIT



**PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË RISKUT
KOMBËTAR LIDHUR ME SHPËLARJEN E PARAVE
DHE FINANCIMIN E TERRORIZMIT NË KOSOVË PËR
VITIN 2013**

PËRMBAJTJA

1. SFONDI.....	4
1.1. Obligimet ndërkombëtare lidhur me vlerësimin e riskut të AML dhe CFT	4
1.2. Përkushtimi i Qeverisë për të vlerësuar dhe menaxhuar riskun për AML dhe CFT	4
2. METODOLOGJITË QË JANË APLIKUAR PËR VLERËSIM TË RISKUT	5
3. PIKËSYNIMI, FUSHËVEPRIMI DHE KRITERET	7
3.1. Pikësynimi dhe fushëveprimi i vlerësimit të riskut	7
3.2. Kriteret e riskut	7
4. RREZIQET E IDENTIFIKUARA DHE MENAXHIMIN E TYRE.....	8
4.1. Rreziqet e identifikuar, të analizuar dhe të vlerësuara.....	8
4.2. Trajtimi dhe menaxhimi i rreziqeve të identifikuar	8
4.3. Publiciteti dhe shpërndarja e vlerësimit të riskut.....	9

1. SFONDI

1.1. Obligimet ndërkombëtare lidhur me vlerësimin e riskut të AML dhe CFT

Rekomandimi i Task Forcës për Veprim Financiar¹ kërkon që shtetet të identifikojnë, të vlerësojnë dhe të kuptojnë riskun e ndërlidhur me shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit në shtet, dhe të ndërmarrin masa, përfshirë emërimin e një autoriteti apo mekanizmi për të koordinuar veprimet e ndërlidhura me vlerësim të riskut, dhe në fund, të shfrytëzojnë burimet për të siguruar zbutjen efikase të rreziqeve. Bazuar në vlerësim, vendi zbaton qasjen e bazuar në rrezik për t'u siguruar që masat për parandalim apo zbutje të shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit të jenë proporcionale me rreziqet e identifikuar.

BE ka nënvizuar nevojën e themelimit të Vlerësimit të riskut kombëtar për shpëlarjen e parave dhe financimin e terrorizmit. Është pjesë e zbatimit të udhëzuesit për liberalizim të vizave për Kosovën.

1.2. Përkushtimi i Qeverisë për të vlerësuar dhe menaxhuar riskun për AML dhe CFT

Qeveria e Kosovës ka vendosur të themelojë Vlerësimin e Riskut Kombëtar për Shpëlarje të Parasë dhe Financim të Terrorizmit në Kosovë në vitin 2013. Procesi i vlerësimit të riskut është një pjesë përbërëse e menaxhimit strategjik. Ky dokument është përmbledhje e Vlerësimit të Riskut Kombëtar për Shpëlarje të Parasë dhe Financim të Terrorizmit për vitin 2013 i cili përbëhet nga dokumentet vijuese të **klasifikuara**²:

- Vlerësimi i Riskut Kombëtar për Shpëlarje të Parasë dhe Financim të Terrorizmit për vitin 2013;
- Matrica për analizë dhe vlerësim për Rreziqe Individuale;
- Plani i veprimit për Masat e trajtimit të Vlerësimit të Riskut Kombëtar për Shpëlarje të Parasë dhe Financim të Terrorizmit për vitin 2013.

Ministria e financave ka lëshuar një Udhëzim Administrativ mbi Vlerësim të Riskut Kombëtar për Shpëlarje të Parasë dhe Financim të Terrorizmit³. Udhëzimi parasheh në hollësi procesin e vlerësimit të riskut për shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit. Udhëzimi administrativ është në përputhje me Rekomandimin FATF 1.

Qeveria e Kosovës ka vendosur t'i përdor rezultatet e Vlerësimit të Riskut Kombëtar për Shpëlarje të Parasë dhe Financim të Terrorizmit në Kosovë për vitin 2013 gjithashtu edhe për parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimeve financiare dhe ekonomike. Kjo për shkak të lidhjes ndërmjet të dy këtyre dukurive, e cila është identifikuar gjatë procesit të vlerësimit të riskut.

¹Standardet ndërkombëtare të luftimit të Shpëlarjes së parasë dhe Financimit të terrorizmit dhe Zgjerimit (Rekomandimet e FATF-së), FATF 2012.

²Vendimi i Ministrisë së Financave Nr. 72/2013 datë 18. 12. 2013, Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-178 për Klasifikimin e informacionit dhe verifikimin e sigurisë, dhe Rregulloren nr. 17/2011 për klasifikimin dhe deklasifikimin e informacioneve.

³Udhëzimi Administrativ i Mf - Nr. 04/ 2013 lidhur me Vlerësim të Riskut Kombëtar për Shpëlarje të Parasë dhe Financim të Terrorizmit, Ministria për financa, 2013.

2. METODOLOGJITË QË JANË APLIKUAR PËR VLERËSIM TË RISKUT

Ministria e financave ka lëshuar një Udhëzim administrativ⁴ i cili përkufizon në detaje procesin e vlerësimit të riskut për shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit. FIU-K harton vlerësimin. Ata mbështeten nga Grupi punues për Vlerësimin e riskut kombëtar i cili përbëhet nga përfaqësues të institucioneve relevante të sektorit publik dhe privat. Për më tepër, konsultimi dhe komunikimi i gjerë me partnerë ka mundësuar përfshirjen e institucioneve më të rëndësishme publike, private dhe të sektorit të tretë, dhe theksuan rëndësinë e partneritetit ndërmjet këtyre hisedarëve. FIU-K, me mbështetjen e Grupit punues për Vlerësimin e riskut kombëtar, ka përfunduar procedurën e vlerësimit të riskut në përputhje me Udhëzimin e FATF-së lidhur me Vlerësimin e riskut kombëtar mbi shpëlarjen e parasë dhe financim të terrorizmit⁵ dhe me standardet ISO 31000⁶ dhe 31010⁷. Besueshmëria dhe cilësia e informatave të grumbulluara është vlerësuar duke aplikuar sistemin e Europol-it 4x4⁸.

Grupi punues për Vlerësimin e riskut kombëtar⁹ ishte në përbërje të përfaqësuesve të institucioneve vijuese:

- Njësia për Inteligjencë financiare në Kosovë;
- Këshilli Prokurorial i Kosovës;
- Agjencia Kundër Korrupsion e Kosovës;
- Administrata Tatimore e Kosovës;
- Policia e Kosovës;
- Doganat e Kosovës;
- Banka Qendrore e Kosovës;
- Agjencia Kosovare e Inteligjencës;
- Ministria e Financave e Kosovës;
- Shoqata e Bankave të Kosovës;
- Projekti i financuar nga BE “Mbështetje institucioneve të Kosovës në luftimin e krimit financiar dhe ekonomik”;
- EULEX-i;
- Thesari i SHBA-së.

Grupi punues për Vlerësimin e riskut kombëtar ka shfrytëzuar burime objektive në komunikim dhe konsultim me partnerë relevant për grumbullim të informatave. Këto burime përbëheshin nga:

- Grumbullimi dhe analiza e statistikave lidhur me shpëlarjen e parave, financim të terrorizmit, krimin ekonomik dhe financiar;
- Grumbullimi dhe analiza e raporteve të vlerësimit lidhur me funksionalitetin e kornizës relevante ligjore dhe mekanizma të tjera parandalues lidhur me shpëlarjen e parasë, financim të terrorizmit, krime financiare dhe ekonomi joformale;

⁴Burimi i njëjtë.

⁵Udhëzimi i FATF-së lidhur me Vlerësim të riskut kombëtar për shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit, 2013.

⁶Menaxhimi i riskut – Parimet dhe udhëzimet, Standardi ndërkombëtar ISO 31000, 2009.

⁷Menaxhimi i riskut – Teknikat e menaxhimit të riskut, Standardi ndërkombëtar ISO 31010, 2009.

⁸Udhëzimet analitike, Europol, 2000.

⁹Lista e takimeve dhe punëtorive organizuar nga Grupi punues për Vlerësim të riskut kombëtar, 2013.

- Vlerësimi i strategjive dhe planeve kombëtare të veprimit për parandalimin e shpëlarjes së parasë, financim të terrorizmit, krimeve financiare dhe ekonomisë joformale.

Komunikimi dhe konsultimi me palët relevante përfshinte burime vijuese subjektive të informatave:

- Takimet dhe punëtoritë¹⁰ e Grupit punues për Vlerësim të riskut kombëtar;
- Pyetësi me bazë në ueb, i cili ka marrë 409 përgjigje nga përfaqësues të institucioneve relevante të sektorit publik, privat dhe të sektorit të tretë¹¹;
- Intervista dhe takime me 53 ekspertë të përfaqësojnë institucione relevante publike, private dhe të sektorit të tretë¹².

FIU-K ia prezanton rezultatet e vlerësimit të riskut Ministrisë së Financave. Ministria ia prezanton Vlerësimin e riskut kombëtar për shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit në Kosovë për vitin 2013 Qeverisë së Kosovës, e cila do ta përdor për të themeluar politika dhe strategji vendore si dhe instrumente të tjera për menaxhim të riskut.

¹⁰Lista e intervistave, takimeve dhe punëtorive të organizuara nga Grupi punues për Vlerësim të riskut kombëtar, , 2013.

¹¹Raporti i rezultateve nga pyetësi në ueb, Ekipi i projektit, Kontrata EuropeAid/132399/C/SER/XK, 2013.

¹²Lista e intervistave, takimeve dhe punëtorive të organizuara nga Grupi punues për Vlerësim të riskut kombëtar, Grupi punues për Vlerësim të riskut kombëtar, 2013.

3. PIKËSYNIMI, FUSHËVEPRIMI DHE KRITERET

3.1. Pikësynimi dhe fushëveprimi i vlerësimit të riskut

Qeveria e Kosovës ka vendosur që Vlerësimi i riskut kombëtar për Shpëlarjen e parave dhe financim të terrorizmit në Kosovë për vitin 2013 të jetë një pjesë përbërëse e procesit të menaxhimit të riskut lidhur me ekonominë joformale dhe shpëlarjen e parave, financim të terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare dhe ekonomike. Tashmë është iniciuar një proces për hartimin e Strategjisë kombëtare për Parandalimin e shpëlarjes së parave, financimit të terrorizmit, krimeve ekonomike, krimeve financiare dhe ekonomisë joformale. Ajo është e bazuar në vlerësimin e riskut dhe do të përbëhet nga masat e trajtimit për rreziqet e identifikuara.

Fushëveprimi i Vlerësimit të Riskut kombëtar 2013 do të mbulojë rreziqet në nivel kombëtar përkitazi me shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit. Procesi për vlerësim të riskut do të shtjellojë gjithashtu rreziqet në nivel kombëtar në raport me ekonominë joformale si dhe krimet financiare dhe ekonomike.

3.2. Kriteret e riskut

Qeveria e Kosovës i ka përcaktuar kriteret që do të aplikohen për të vlerësuar peshën e riskut. Është vendosur që kriteret e riskut duhet të pasqyrojnë vlerat dhe pikësynimet e legjislacionit përkatës vendor dhe të shoqërisë në tërësi. Prandaj, kriteret e riskut janë nxjerrë nga pikësynimet e Ligjit mbi shpëlarjen e parasë dhe financim të terrorizmit¹³ dhe nga Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011 - 2014¹⁴. Bazuar në vlerat dhe pikësynimet e lartpërmendura, kriteret e riskut për Vlerësim të riskut kombëtar për shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit në Kosovë për vitin 2013 janë si në vijim:

1. Parandalimi dhe zbulimi efikas i shpëlarjes së parasë dhe financimit të terrorizmit;
2. Zhvillim të qëndrueshëm ekonomik;
3. Qeverisja e mirë dhe fuqizimi i sundimit të ligjit;
4. Zhvillimi i kapitalit njerëzor;
5. Mirëqenia sociale.

¹³ Ligji nr. 03/L-196 dhe Ligji nr. 04/L-178 për parandalimin e shpëlarjes së parasë dhe financim të terrorizmit, 2010 dhe 2013.

¹⁴ Programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës 2011-2014, 2011.

4. RREZIQET E IDENTIFIKUARA DHE MENAXHIMIN E TYRE

4.1. Rreziqet e identifikuara, të analizuar dhe të vlerësuara

Grupi punues për Vlerësim të riskut kombëtar është konsultuar dhe komunikuar me partnerë relevantë dhe ka analizuar dhe vlerësuar¹⁵ informatat e mbledhura. Ky proces i vlerësimit të riskut ka prodhuar një listë të prioritizuar e cila përbëhet nga gjithsej 35 rreziqe të identifikuar, të cilat janë klasifikuar në kërcënime dhe dobësi.

Rreziqet potenciale kishin të bënin me ngjarje dhe pasoja vijuese:

- Efikasiteti i procedurave të planifikimi të performancës në sektorin publik;
- Efikasiteti i mekanizmave për zbulim dhe parandalim të korrupsionit, krimeve të tjera financiare dhe ekonomisë joformale në Kosovë si dhe ndikimin e tyre në investime ndërkombëtare dhe rritje ekonomike;
- Efikasiteti i zbatimit të kornizës ligjore;
- Mbulueshmëria me legjislacion dytësor dhe procedura standarde të punës;
- Efikasiteti i procedurave për përcjellje të aseteve dhe për konfiskim;
- Efikasiteti i zbatimit të aktgjykimeve për konfiskim, dënimeve administrative dhe procedurave të insolvencës;
- Kapaciteti dhe shkathtësitë e gjyqësorit;
- Transparenca dhe llogaridhënia në administratën publike;
- Nepotizmi;
- Shtrirja e ekonomisë joformale;
- Ndikimet e ekonomisë së bazuar në të holla të gatshme;
- Ndjeshmëria e Kosovës ndaj krimeve financiare;
- Ndjeshmëria e Kosovës ndaj shpëlarjes së parasë;
- Natyra e veprave penale të shpëlarjes së parasë;
- Përmasat e kriminalitetit të fshehur në lidhje me shpëlarjen e parasë dhe krimeve të tjera financiare;
- Funkcionaliteti i mekanizmave raportues për transaksione të dyshimta dhe me të holla të gatshme;
- Cenueshmëria e disa sektorëve ndaj ekonomisë joformale, shpëlarjes së parasë dhe krimeve të tjera financiare dhe ekonomike.

4.2. Trajtimi dhe menaxhimi i rreziqeve të identifikuar

Grupi punues për Vlerësim të riskut kombëtar i ka përcaktuar masat e trajtimit për rreziqet e identifikuar. Këto janë si në vijim:

1. Ngritja e vetëdijes lidhur me ndikimet dhe parandalimin e ekonomisë joformale dhe krimeve financiare;
2. Fuqizimi i parandalimi i ekonomisë joformale dhe krimeve financiare përmes transparencës, llogaridhënies, qeverisjes së mirë dhe partneritetit shoqëror;

¹⁵ Matrica e analizës dhe vlerësimit për rreziqe individuale, Aneksi 1 i Vlerësimi të riskut kombëtar për shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit në Kosovë për vitin 2013, Grupi për vlerësim të riskut kombëtar, 2013.

3. Promovim i inteligjencës, hetimit, ndjekjes penale, procedurave gjyqësore dhe të përmbartimit për shpëlarje të parasë, financim të terrorizmit dhe krime të tjera financiare;
4. Fuqizimi i kapacitetit të institucioneve relevante;
5. Zhvillimi dhe zbatimi i qasjes proaktive ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar në parandalimin e shpëlarjes së parasë, financimin e terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare;
6. Zhvillimi i legjislacionit kombëtar në mënyrë që të jetë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe zbatimi efikas i tij.

Grupi për vlerësim të riskut kombëtar ka hartuar një Plan veprimi¹⁶ për zbatim të masave të trajtimit. Ai përbëhet nga gjithsej 57 aktivitete individuale.

Vlerësimi i riskut ndërkombëtar për shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit në Kosovë për vitin 2013 do të jetë bazë për Strategjinë kombëtare dhe Planin e veprimit për shpëlarje të parasë, financim të terrorizmit, krime financiare dhe ekonomike si dhe ekonominë joformale 2014-2018. Këto dokumente të politikës përbëjnë instrumente të menaxhimit të riskut lidhur me këto dukuri të dëmshme në Kosovë. Strategjia kombëtare dhe plani i veprimit përbëhet nga mekanizma për monitorim dhe shqyrtim për të siguruar zbatim efikas të masave të trajtimit, me fokus në rreziqet e identifikuara nga Vlerësimi i riskut kombëtar 2013. Ky funksion sigurohet nga Qeveria e Kosovës.

4.3. Publiciteti dhe shpërndarja e vlerësimit të riskut

Rezultatet Vlerësimi të riskut kombëtar për shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit në Kosovë për vitin 2013 janë publikuar dhe shpërndarë institucioneve publike, private dhe të sektorit të tretë, në mënyrë që të shfrytëzohen për vendim-marrje në lidhje me parandalimin e shpëlarjes së parasë, financimit të terrorizmit, ekonomisë joformale dhe krimet financiare dhe ekonomike. Ministria për financa ka vendosur më 16. 12. 2013 ta klasifikojë Vlerësimin e riskut kombëtar lidhur me shpëlarjen e parasë dhe financim të Kosovës për vitin 2013, me Anekset e saj 1-2. Vendimi është marrë në përputhje me Ligjin mbi qasjen në dokumente publike¹⁷. Qeveria e Kosovës ka vendosur që të botojë këtë Përmbledhje të Vlerësimit të Riskut kombëtar për shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit në Kosovë në vitin 2013 dhe t'i shpërndajë rezultatet e vlerësimit të riskut me institucionet publike, private dhe të sektorit të tretë, në mënyrë që të përdoret për vendim-marrje.

Qeveria e Kosovës aktualisht është duke hartuar Strategjinë kombëtare dhe Planin e veprimit për parandalim të shpëlarjes së parasë, financimit të terrorizmit, krimeve ekonomike, financiare dhe të ekonomisë joformale 2014-2018. Ajo bazohet në rezultatet e Vlerësimi të riskut kombëtar për shpëlarje të parasë dhe financim të terrorizmit në Kosovë për vitin 2013. Strategjia kombëtare dhe Planin i veprimit përfshin masa të cilat konsiderohen si të domosdoshme për të trajtuar dhe menaxhuar rreziqet e ndërlidhura me ekonominë joformale, shpëlarje të parasë, financim të terrorizmit dhe krimin financiar dhe ekonomik. Qeveria e Kosovës do të botojë Strategjinë Kombëtare dhe Planin e Veprimit për

¹⁶ Planin e veprimit për masat e trajtimit të Vlerësimit të riskut kombëtar nga shpëlarja e parasë dhe financim të terrorizmit në Kosovë për vitin 2013, Aneksi 2 i Vlerësimit të riskut kombëtar nga shpëlarja e parasë dhe financim të terrorizmit në Kosovë për vitin 2013, Grupi punues i Vlerësimit të riskut kombëtar, 2013.

¹⁷ Ligji nr 03/L – 215 për qasje në dokumente publike, 2010.

shpëlarje të parasë, financim të terrorizmit, krimeve ekonomike, krimeve financiare dhe ekonomisë joformale 2014-2018.